



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute*

# *Arsimim Ligjor për Drejtësi*

maj 2011, Prishtinë

## Përmbajtja

- Hyrje
- Misioni dhe  
Funksionet e IGJK-së
- Programi i  
Vazhdueshëm për  
Arsimim Ligjor
- Programi Fillestar  
për Arsimim Ligjor
- Provimi Përgatitor
- Programi i Trajnimit  
për Avancim
- Trajnimi i  
gjqqtarëve porotë
- Trajnimi i  
profesionistëve tjerë në  
fushën e gjyqësisë
- Hulumtimet dhe  
Publikimet



Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) ka shënuar 10 (dhjetë) vite nga themelimi i tij. Rezultatet e arritura gjatë kësaj kohe janë inspirim për rritjen e aktiviteteve në të ardhmen.

Përkundër shumë sfidave të karakterit administrativ e financiar, në bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, IGJK ka arritur të fillojë zbatimin e programeve të reja për përgatitjen e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm dhe zhvillojë më tutje programet ekzistuese për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë.

Këto programe trajnuese të IGJK-së, pa dyshim se kontribuojë në konsolidimin e një sistemi profesional gjyqësor e prokurorial në Kosovë.

Ndihem i privilegjuar që në emër të IGJK-së të komunikojmë përmes kësaj fletushke e cila në një formë të përmbledhur prezanton misionin dhe funksionet e IGJK-së për ofrimin e shërbimeve kualitative të arsimimit ligjor.

Jam i bindur se shërbimet IGJK-së do të ndihmojnë ndërtimin e një sistemi gjyqësor e prokurorial profesional i cili mbron të drejtat individuale, mirëqenien e përgjithshme dhe rrit besimin e publikut.

Sinqerisht,

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'S. Sinani', written on a white rectangular background.

## ***Hyrje***

Brenda mandatit për ndërtimin e institucioneve, Misioni i OSBE-së në Kosovë në bazë të parimeve për të drejtat e njeriut dhe sundimit të ligjit ndihmoj Kosovën në zhvillimin e sistemit gjyqësor.

Misioni i OSBE-së, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit themeloi sektorin për trajnime gjyqësore, i cili më vonë në shkurt të vitit 2000, u riemërua si Instituti Gjyqësor i Kosovës.

Më 24 prill 2006, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara miratoi Rregulloren 2006/23 për shpalljen e Ligjit për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës. Ky ligj u miratua nga Kuvendi i Kosovës në shkurt 2006, përmes të cilit IGJK u bë institucion i pavarur profesional dhe kryesor për aftësim profesional brenda sistemit gjyqësor të Kosovës i cili duhet t'i përmbush funksionet e veta bazuar në parimet e ligjshmërisë, paanshmërisë dhe efikasitetit.



## ***Misioni dhe Funkcionet e Institutit Gjyqësor të Kosovës***

Qëllimi i IGJK-së është që duke shfrytëzuar teknikat më të avancuara dhe më efektive të mësimdhënies, të ofrojë cilësinë më të lartë të arsimimit ligjor dhe përgatitjes profesionale për gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë.

Si pjesë e këtij qëllimi, IGJK do të ofrojë trajnime për secilin gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë. Ky qëllim përfshin edhe aspiratën për krijimin e shkollës më të avancuar për gjyqtarë dhe prokurorë në tërë rajonin për përgatitjen e kuadrove të reja të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në mbështetje të këtij qëllimi, IGJK do ta zhvillojë edhe më tej, bashkëpunimin me të gjithë partnerët e vet për avancimin e praktikave më të mira të arsimimit profesional ligjor për përfituesit e programeve të tij.

Përgjegjësitë kryesore të cilat janë të përcaktuara në nenin 2 të Ligjit për Themelimin e IGJK-së janë; aftësimi i bartësve dhe bartësve potencial të funksionit në gjyqësi (gjyqtarëve dhe prokurorëve), vlerësimi dhe organizimi i Provimit Përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë, kurset e posaçme të aftësimit për avancim të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kurse për aftësimin bazë të gjyqtarëve porotë dhe kurse për aftësimin e profesionistëve të tjerë në lëmin gjyqësisë të identifikuar nga IGJK.

IGJK gjatë punës së vet zhvillon plane aftësimi afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për një gjyqësi efikase, efektive dhe të paanshme dhe kryen edhe veprimtari të tjera profesionale si institucion profesional-kërkimor për zhvillimin e gjyqësisë në Kosovë në pajtim me standardet ndërkombëtare.

## Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL)

Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor është program trajnimi i vili iu dedikohet gjyqtarë ve dhe prokurorëve të cilët aktualisht ushtrojnë funksionin e tyre.

Ky program trajnues hartohet nga stafi, ekspertët dhe trajnuesit e IGJK-së, duke përdorur teknika dhe metodologji të veçanta të cilat mundësojnë n j ë program gjithëpërfshirës dhe të llojllojshëm.

Pas hartimit, ky program diskutohet dhe përpunohet nga Këshilli Programor i IGJK-së dhe në fund merr miratimin nga Këshilli Drejtues.

Qëllimi kryesor i këtij programi trajnues është zhvillimi dhe avancimi i shkathtësive profesionale dhe ekspertizës ligjore për gjyqtarë dhe prokurorë të cilët i ushtrojnë funksionet e tyre.


PVAL përmban për trajtim çështje nga:

- E Drejta Penale (materiale dhe procedurale),
- Drejtësia për të Mitur,
- E Drejta Civile (pjesa e përgjithshme dhe procedura civile),
- Lëmia Administrative dhe Kushtetuese,
- E Drejta Evropiane dhe Konventat Evropiane për të Drejtat e Lirë Themelore të Njeriut,
- Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve,
- Lëmia e Ndërrimeve

Trajnimet e realizuara në PVAL 2000-2010  
Trajnimet e realizuara në PVAL 2000-2010

Përfitues të trajnimeve të përcaktuara me PVAL, janë:

- Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve të cilët ushtrojnë funksionet e tyre,
- Në disa kurse trajnuese, përfitues të trajnimeve janë edhe avokatët, Policia e Kosovës, zyrtarët e shërbimit sprovues dhe qendrave për punë sociale.





## **Programi i Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL)**

Programi Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL) është program trajnimi i cili iu dedikohet kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm të cilët pasi ta kenë kaluar Provimin

Përgatitor/Hyrës i nënshtrohen këtij programi trajnues në disa module për një periudhë të caktuar kohore. Ky program është i ndarë në tri faza.

- Faza e parë zgjatë 6 muaj. Në këtë periudhë trajnohen së bashku kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë. Në këtë fazë organizohen trajnime nga bazat e përgjithshme të sistemit juridik dhe atij gjyqësor.
- Faza e dytë zgjatë 3 muaj. Në këtë fazë trajnohen ndaras kandidatët për gjyqtarë nga ata për prokurorë. Në këtë fazë trajnimet mbështeten në specifikat e punës së tyre.

- Faza e tretë zgjatë 6 muaj. Kjo është fazë specifike sepse në këtë periudhë kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë kalojnë në gjykata dhe prokurori, ku ushtrojnë punën praktike, nën mbikëqyrjen e mentorëve të tyre (gjyqtarë/prokurorë).

Karakteristikë e fazës së tretë është se me fillimin e saj për IGJK-në krijohen parakushtet për pranimin e gjeneratës tjetër të kandidatëve, pasi që kandidatët nga gjenerata paraprake nuk do të jenë më (fizikisht) në IGJK.

Realizimi i këtij programi trajnues bëhet bazuar në 34 module (programe trajnuese) të cilat në fakt janë lëndë për të cilat marrin trajnim kandidatët gjatë qëndrimit në IGJK.

Gjenerata e parë dhe e dytë e PFAL tashmë janë emëruar në funksione të gjyqtarëve apo prokurorëve, ndërsa aktualisht, në trajnim janë gjenerata e tretë (32 kandidatë) dhe gjenerata e katërt (57 kandidatë).



## Provimi Përgatitor/Hyrës

Në bazë të Ligjit për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës (neni 2.1.a dhe 7), IGJK është përgjegjëse për organizimin dhe vlerësimin e Provimit Përgatitor/Hyrës për gjyqtarë dhe prokurorë i cili është parakusht për fillimin e ndjekjes së trajnimeve në PFAL nga këta kandidatë.

Ky provim organizohet me qëllim të vlerësimit profesional të të gjithë kandidatëve të cilët pretendojnë që në të ardhmen të ushtrojnë funksionin e gjyqtarit apo prokurorit.



Në vitin 2011, të drejtën për t'i ndjekur trajnimet në Programin Fillestar për Arsimit Ligjor e kanë fituar 42 kandidatë, por pasi që Këshilli Gjyqësor ka vendosur që të pranohet kandidatët që kanë përfunduar provimin në vitin 2009, atëherë të drejtën për të vijuar trajnimet gjatë vitit 2011 e kanë fituar gjithsej 59 kandidatë.



### **Programi i Trajnimit për Avancim (PTA)**

Ky program trajnimi nënkupton organizimin e kurseve të posaçme aftësimi për gjyqtarë dhe prokurorë që janë apo që do të avancohen brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës dhe do të hartohet në konsultim me KGJK-në dhe KPK-në.

PTA e ka bazën në nenin 10 të Ligjit për IGJK-në si dhe nenin 16 të Statutit të IGJK-së.

Sipas ligjit për IGJK-në, gjyqtarët dhe prokurorët e posa emëruar kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë në kurset e veçanta për aftësim dhe avancim, pa shprehur nga marrëdhënia e punës, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Mbështetur në nenin 16 të Statutit të IGJK-së këto kurse trajnuese do të organizohen për dy kategori të përfituesve:

Për gjyqtarë dhe prokurorë që aktualisht ushtrojnë funksionet e tyre, ndërsa Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial vendosë avancimin e tyre nga nivelet më të ulëta në nivele më të larta.

Për gjyqtarët dhe prokurorët e posa emëruar të cilët më parë nuk kanë punuar në pozita të tilla.

Programi i Trajnimit për Avancim është program specifik pasi që për herë të parë organizohen kurse të veçanta trajnimi për gjyqtarët dhe prokurorët e niveleve të ndryshme të cilët avancohen në detyrë.





### ***Trajnimi i gjyqtarëve porotë***

Mbështetur ne nenin 2.1.(d) të Ligjit mbi themelimin e tij, IGJK është përgjegjës për organizim të kurseve për aftësimin bazë të gjyqtarëve porotë.

Qëllimi i këtyre kurseve trajnuese është ngritja e kapaciteteve vendimmarrëse të gjyqtarëve porotë gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore të përcaktuar në kompetencë të tyre.

Këto kurse trajnuese janë të nivelit bazik dhe të avancuar. Ato organizohen në formë të seminareve dhe tryezave të punës si dhe kanë karakter regjional.

### ***Trajnimi i profesionistëve tjerë në fushën e gjyqësisë***

Duke u bazuar në nenin 2.1 (e) të Ligjit mbi Themelimin e IGJK-së, IGJK organizon kurse për aftësimin e profesionistëve tjerë në lëmin e gjyqësisë.


Qëllimi i këtij programi trajnues është forcimi i rolit të bashkëpunëtorëve profesional dhe stafit mbështetës të gjykatave dhe prokurorive në mënyrë që përmes tyre të sigurohet një mbështetjeje më e madhe për gjyqtarët dhe prokurorët.



## ***Vlerësimet e pjesëmarrësve të trajnimeve***

1. Trajnimet janë shumë të dobishme në thellimin e njohurive të nevojshme.
2. Metoda e qasjes praktike të mësimit të avancuar është metodë e dobishme për të ardhmen.
3. IGJK të vazhdoj organizimin e trajnimeve në nivel regjional me përfshirje më të madhe të gjyqtarëve, dhe të ketë lloje të seminareve për interpretim të ligjeve.
4. Të organizohen seminare të tilla me qëllim që të kemi një kuadër të mirë profesional.
5. Trajnime lidhur me Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut të mbahen më shpesh sepse për një pjesë të gjyqtarëve janë më pak të njohura e për këto njohuri kemi nevojë.





Rruga “Muharrem  
Fejza” pa numër Prishtinë

Tel: +381 38 512 069

+381 38 512 081

+381 38 512 095

Fax: +381 38 512 069 / 212

[www.kjjudicial.org](http://www.kjjudicial.org)

